



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT KADASTRËS DHE INVESTIMEVE
PUBLIKE

Nr 5408 Prot

Vau Dejës, 22 . 09 . 2025

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar Z. Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt-Vendimin, "Për miratimin revokimin e VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 *"Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë, ish magazine H/C Vau Dejës"*.

Bashkëlidhur:

1. Projekt-Vendimi;
2. Relacion shpjegues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Datë: _____

Nr.Faqeve A4 të projekt-propozimit _____

Nr.Faqeve A4 të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KRYETARI**

Nr. — Prot.

Vau Dejes, më 22.09.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 2, datë 22 / 09 / 2025

“Për revokim të VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji I pasurisë, ish magazine H/C Vau Dejës”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji Nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar; Ligji Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” I ndryshuar; VKM Nr.1423, datë 10.10.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vau Dejës” të Qarkut Shkodër i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; pas reflektimit mbi shkresën e Përefektit të Qarkut Shkodër Nr.125/1 Prot, datë 13.02.2024, (duke e revokuar si të tërë vendimin dhe jo në mënyrë të pjesëshme), dhe nisur nga projekt propozimi i ardhur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike, për shkak të investimeve në rivitalizimin e qendrës së qytetit dhe lirimit të hapësirave publike në shërbim në komunitet, Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë votave.

VENDOSI:

1. Revokim të VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë, ish magazine H/C Vau Dejës”, për shkak të investimeve në rivitalizimin e qendrës së qytetit dhe lirimit të hapësirave publike në shërbim në komunitet (si e vetmja hapësirë për qendrën e qytetit).

2. Ky vendim i kalohet për zbatim Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike dhe Drejtorisë Ligjore PP dhe Aseteve për procedurat e mëtejshme me ministrinë e linjës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" (I ndryshuar).

KRYETARI
Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETARI

Aleksandër Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT KADASTRËS DHE INVESTIMEVE
PUBLIKE

Nr. Prot

Vau Dejës, 22.09.2025

Lënda: Relacion shpjegues mbi miratimin për revokim të VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji I pasurisë, ish magazine H/C Vau Dejës”.

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji Nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar; Ligji Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar; VKM Nr.1423, datë 10.10.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Vau Dejës” të Qarkut Shkodër i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Me riorganizimin territorial të ndarjeve administrativo territoriale ne mbështetje të ligjit Nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar u bë krijimi i Bashkisë Vau Dejës njësi e cila trashëgon të drejtat e pronësisë dhe detyrimet sipas VKM Nr.510 dt.10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekur nga riorganizimi administrativo-territorial”, si dhe miratimin e planeve të përgjithshme vendore, ku janë përcaktuar edhe zonat e zhvillimit, janë bërë disa korrespondenca të njëpasnjëshme me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e përgjithshme të pronës publike, Drejtorinë e privatizimit po ashtu edhe me Perfaqësimin e Qarkut Shkodër lidhur me anulimin e procedurave të privatizimit për ish magazinat e H/C Vau Dejës transferuar në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, prishjen e tyre dhe miratimin e projekta për planin për rivitalizimin e qendrës së qytetit Vau Dejës. Nga studimi i zonës, aty është e vetmja pronë

publike, qe mund te përdoret për hapësira publike, si qendër e qytetit. Pas shqyrtimit të rastit nga institucionet përkatëse konkretisht mbi shkresën e Perfektit të Qarkut Shkodër Nr.1259

Prot, datë 13.02.2024, na është kërkuar për tu bërë revokimi si i tërë vendimit dhe jo në mënyrë të pjesshme dhe nisur nga projekt propozimi i ardhur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike, për shkak të investimeve në rivitalizimin e qendrës së qytetit dhe lirimit të hapësirave publike në shërbim në komunitet, Këshilli Bashfak, pas diskutimit dhe miratimit me shumice votave kemi arritur në konkluzionin e arsyeshëm që ndjekja e procedurës së miratimit për **revokimin** e VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë, lloji i magazinave H/C Vau Dejës” është zgjedhja e duhur për **qendrën e qytetit dhe lirin e hapësirave publike në shërbim në komunitet (bashkëngjitur shkresa me Perfektin e Qarkut Shkodër).**

1. *Objekt i këtij Projekt-Vendimi është revokimi i VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me nr.6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë, lloji i magazinave H/C Vau Dejës”, për shkak të investimeve në rivitalizimin e qendrës së qytetit dhe lirimit të hapësirave publike në shërbim në komunitet (si e vetmja hapësirë për qytetin e qytetit).*

2. *Anulimi i çdo procedure të mundshme për vijimin e privatizimit të këtyre pasurive kërkohet për arsyen se bie ndesh me vizionin e Bashkisë Vau Dejës për rivitalizimin e këtyre territoreve. Vendndodhja e këtyre magazinave është një pikë strategjike për qytetin dhe për qytetarët e tij, dhe për rrjedhojë bashkia nuk mundet të shprehet pozitiv për privatizimin e këtyre trojeve në të cilat janë projektuar si hapësira të cilat do t’ju kthehen qytetarëve në shërbime rekreacioni dhe pushimi.*

Territoret e lira në qendrën e qytetit janë të pakta për mos të thënë që këto prona janë si vetmet, gjë që na sjell detyrimin moral dhe ligjor për tu shprehur kundër këtij privatizimi, pasi projektet private nuk mundë të quhen më madhore se sa përfitimi publik që është

projektuar të merret nga këto prona, bazuar në projektet konkrete që bashkia Vau Dejës ka për to.

Sa më lart, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës duke konsideruar propozimin e bërë në emër të komunitetit të zonës, u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë:

1.Të "Miratojë revokimin e VKB –së Nr. 37, datë 05.12.2013 "Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurive shtetërore, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me lloje 6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr.8598, lloji i pasurisë, ish magazine IDG Vau D. 20"

KRYETARI

Kristian Shkreli

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKIA VAU-DEJES

VENDIM

Nr. 37 date 05/12/2013

Per miratimin e fillimit te procedurave te privatizimit te pasurive shtetore, prone e Bashkise Vau-Dejes, me nr. 6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale, nr. 8598, lloji i pasurise, ish magazina te H/C Vau-Dejes.

Keshilli Bashkise Vau-Dejes i mbledhur me dt. 05.12.2013, pasi shqyrtoj projekt-vendimin e paraqitur nga zyra e pronave dhe urbanistikes "Per miratimin e fillimit te procedurave te privatizimit te pasurive shtetore, prone e Bashkise Vau-Dejes, me nr. 6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale nr. 8598, lloji i pasurise, ish magazina te H/C Vau-Dejes, mbeshtetur ne ligjin nr. 8652, dt. 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 8, pika 1, kreu II, germa a, neni 32, germa e, neni 33, pika 4, ne ligjin nr. 8743, dt. 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit", ne ligjin nr. 8744, dt. 22.02.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesit e qeverisjes vendore", ne VKM, nr. 1423, dt. 10.10.2008 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave publike shtetore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim Bashkise Vau-Dejes te qarkut Shkoder", ne VKM, nr. 428, DT. 09.06.2010 "Per kriteret e vleresimit te prones shtetore qe privatizohet, apo transferohet dhe per procedurat e shitjes", Udhhezimin nr. 01, dt. 22.11.2010 "Ne zbatim te VKM, nr. 428, dt. 09.06.2010 "Per perfshirjen ne procesin e privatizimit, pronat qe kane kaluar ne pronesi te pushtetit vendore", ne Shkresen nr. 1741, prot. dt. 23.04.2012, te Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve, Drejtoria e Privatizimit, prane Ministrise se Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes.

Pas diskutimeve dhe miratimit me 17 vota pro, asnje kundra, asnje abstenim:

VENDOSI

1. Te miratoje fillimin e procedurave te privatizimit te pasurive shtetore, prone e Bashkise Vau-Dejes, me nr. 6/7, 6/8, 6/64, 6/73, 6/74, zona kadastrale nr. 8598, lloji pasurise, ish magazina te H/C Vau-Dejes.
2. Ngarkohet per zbatim zyra e pronave dhe urbanistikes.
3. Ky vendim hyn ne fuqi pas shprehjes se ligjshmerise nga Prefekti Qarkut Shkoder,

KRYETARI I KESHILLIT
Myftar BABAJ

ASHV Shkodër, F. 10, V. 2013, D. 15, fl. 1